V E N D I M
Nr.53, datë 29.1.1993

PËR MBARËVAJTJEN E PUNËS KËRKIMORE-SHKËNCORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Me qëllim që të përmirësohet puna kërkimore-shkencore në Republiken e Shqipërisë dhe, në mënyrë të veçantë, në Akademinë e Shkencave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Për drejtimin e reformës në Akademinë e Shkencave të ngrihet një grup pune i përbërë prej 3 punonjësish shkencorë me kualifikim të lartë, të caktuar nga Kryetari i Këshillit të Ministrave, i cili "ad interim" të drejtojë Akademinë deri në fillimin normal të punës në të.

2. Të krijohet nga Kryesia e Këshillit të Ministrave nje grup pune, i cili në bashkëpunim me Komitetin e Shkencave dhe të Teknologjisë të paraqesë brenda muajit shkurt 1993 statutin e ri të Akademisë së Shkencave në kushtet e demokracisë dhe të shtetit ligjor.

3. Deri në miratimin e statutit të ri të pezullohen strukturat drejtuese të Akademisë së Shkencave, si dhe të gjithë drejtuesit e instituteve dhe qendrave kërkimore që janë për një kohë më të gjatë se dy vjet në atë detyrë.

Për drejtimin e punëve në institutet dhe qendrat kërkimore deri në miratimin e statutit të ri ngarkohen zëvendësit e tyre.

4. Brenda muajit shkurt të paraqitet në qeveri rregullorja për mbrojtjen e gradave shkencore, si dhe klasifikimi dhe dhënia e titujve të punonjësve kërkimorë e atyre pedagogjikë.

5. Të përfundojë, brenda muajit shkurt, puna për verifikimin dhe vlerësimin e titujve dhe gradave shkencore mbështetur në vendimin nr. 360, datë 10.8.1992 të Këshillit të Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi